

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Gëzim LLulluni dhe Nora Bllaca Dula, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses KEP-Trust me seli në Prishtinë Rr.”Bajram Kelmendi” nr.6, të cilën e përfaqëson i autorizuari L.L. nga Peja, kundër të paditurve A.B. nga Peja dhe L.K. nga fshati ..., Komuna e Pejës, për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit A.B., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.279/11, i datës 04.11.2014, në seancën jo publike të mbajtur me datë 22.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit A.B. nga Peja, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.279/11, i datës 04.11.2014, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.279/11, i datës 04.11.2014, i ka detyruar të paditurit A.B. nga Peja dhe L.K. nga fshati ..., Komuna e Pejës, që në mënyrë solidare ti paguajnë paditëses KEP-Trust me seli në Prishtinë, borxhin kryesor dhe kamatën e rregullt në shumë të përgjithshme prej 5.959,37 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 50 Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë

Kundër këtij aktgjykimi i padituri A.B. në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e të paditurit si e bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë ashtu që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses, apo të njëjtin ta prishë dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja KEP-Trust me seli në Prishtinë, me datë 05.03.2010, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit përmbarimor Kontratës mbi Huan nr.KOPE-015757/001, e datës 05.02.2009, dhe Kontratës mbi Pengun, e datës 04.02.2009, kundër debitorës-paditurës A.SH. nga Peja, për sekuestrimin e kolateralit në lartësi prej 5.542,78 Euro.

Meqenëse automjetet e lënda peng janë tjetërsuar, dhe detyrimi nuk ka mundur që të realizohet në procedurën përmbarimore, paditësja KEP-Trust me seli në Prishtinë, me datë 04.05.2011, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurës A.SH. nga Peja, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia kthej borxhin në shumë prej 5.959,37 Euro, me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës gjyqësore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Paditësja me parashtresën e datës 24.12.2013, pas vdekjes së të paditurës A.SH., ka bërë precizimin e padisë në kuptimin subjektiv, ndaj garantuesve L.K., nga fshati ..., Komuna e Pejës, dhe A.B., Rr.“...”, Komuna e Pejës, si garantues të të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave ka marrë aktgjykimin e atakuar C.nr.279/11, i datës 04.11.2014, me të cilin e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se e paditura A.SH., nga paditësja ka marrë kredi në shumë prej 5000 Euro, ndërsa këtu të paditurit janë bashkë huamarrës-garantues, ku nga marrëveshja mbi pengun është vërtetuar se janë lënë peng autobusi setra dhe vetura WV-kie.

Ka shtuar se detyrimi i të paditurve për pagimin e borxhit paditëses rrjedhë nga kontrata mbi kredinë e datës 05.02.2009, ku në nenin 7 pika 3 të kësaj kontrate kanë paraparë që në rast të fatkeqësisë apo vdekjes së huamarrësit të gjitha detyrimet kalojnë në garantuesit.

Gjykata ka arsyetuar se në rastin konkret ekziston detyrimi juridiko-civil i të paditurve ndaj paditëses për borxhin e papaguar së bashku me kamatën në shumë prej 5.959,37 Euro.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e morri duke u bazuar në dispozitivin e nenit 124, 262 dhe 277 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në kuptim të dispozitës së nenit 452 paragrafi 1 i LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore si bazë për të vendosur ndryshe nga shkaku se ankuesi në arsyetimin e ankesës i është referuar rrethanave të pafavorshme ekonomike për shkak të numrit të anëtarëve të familjes, gjë që sipas vlerësimit të gjykatës ankimore është krejtësisht e parëndësishme për shkak se në rastin konkret detyrimi për të paditurin rrjedhë nga raporti kontraktual i palëve ndërgjyqësore. Gjykata ankimore nuk mund ta marrë në konsideratë kërkesën e tij që detyrimin ta përmbush me këste, për shkak se në këtë fazë të procedurës kërkesa është bërë e arritshme, ndërsa pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit mënyra dhe mjetet e përmbarimit i takojnë procedurës së përmbarimit.

Nga arsyet e cekura gjykata ankimore vlerëson se edhe e drejta materiale që vlerësohet sipas detyrës zyrtare në këtë rast është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Mbi këtë gjendje faktike të konstatuar sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, pasi që me dispozitën e nenit 148 paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (LMD i vitit 1978) përcaktohet se :” *Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese*”, ndërsa me dispozitën e nenit 262 paragrafi 1 parashihet se: ”*Kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij*”. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4832/14, me datë 22.05.2018

Kryetari i kolegjit

Albert Zogaj, d.v